

PROCESVERBAL

Nga seanca e tridhjetë e katërt e Këshillit të Komunës së Bërvenicës, e mbajtur më 27.05.2024, (e hënë) me fillim nga ora 13:00 në ambientet e Komunës së Bërvenicës.

Të pranishëm: 11 këshilltarë.

Mungojnë: Adem Jetmir Jashari, Emin Mehdiju, Alihasan Idrizi dhe Svetlana Stamatovska

Seancën e hapi dhe e drejtoi kryetari i Këshillit, Bujamin Rushiti, i cili tha se ka kuorum për vendimmarrje të vlefshme nga numri i këshilltarëve të pranishëm.

Kryetari i Këshillit tha, para se të lexoj rendin e ditës, duhet të them se kemi ndryshim të rendit të ditës, pikën e katërt do ta lëmë për seancën e ardhshme, sepse do të ketë ndryshime në ligj. Do të doja që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe më pas të diskutojmë për rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit pyeti se kush ishte për ta hequr këtë pikë nga rendi i ditës dhe për ta hedhur në votim propozimin. I njëjti u pranua nga të gjithë këshilltarët e pranishëm.

Kryetari i Këshillit pyeti nëse ka pasur pyetje të këshilltarëve pasi ato diskutohen para rendit të ditës.

Për punën e seancës u propozua rendi i ditës në vijim.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së tridhjetë e tretë të Këshillit të Komunës së Bërvenicës.
2. Propozim-Vendim për përcaktimin e lokacionit të përkohshëm për deponimin e mbeturinave inerte (rrënojat e ndërtimit).
3. Propozim-Vendim për zonat dhe lëvizjen e vlerës së tregut të tokës ndërtimore dhe bujqësore në rajonin e Bërvenicës, për rregullimin e tatimit në pronë dhe qarkullimit të patundshmërive, trashëgimisë dhe dhuratës.
4. Propozim-Vendim për rritjen e normës së patundshme dhe të pashfrytëzuara si dhe revizioni e vlerës së tregut të patundshmërisë.
5. Raporti përfundimtar nga revizionin e brendshëm të punës së Sektorit për Tatime dhe Administratë me Taksat në komunën e Bërvenicës për periudhën nga 01.01.2023 deri më 31.12.2023.
6. Propozim-Vendim për shpërblim me para për të parët e gjeneratës për vitin 2024.
7. Propozim-Vendim për pajisjen me kapele, shalle dhe fotosesion për të gjithë maurantët në zonën e Bërvenicës.
8. Propozim-Vendim për ndihmë financiare të njëhershme për blerjen e mjeteve shkollore për familjet me nxënës të klasës së parë në SHK në rajonin e Bërvenicës

Kryetari i Këshillit tha, si gjithmonë, para se të lexoj rendin e ditës, vijojn pyetjet e Këshillit nëse dikush ka diçka për të pyetur.

Abeb Nuhiu u paraqit për fjalë dhe tha, kam dy kërkesa nga fshati Gurgurnicë , pasi Adem Jashari do të vonohet pak, kështu që unë do t'i paraqes kërkesat. Bëhet fjalë për rrugën kryesore që të çon në fshatin Gurgurnicë, nuk mund të përdoret sepse ka nevojë për pastrim, ka drunjë përgjatë rrugës dhe është e prishur, presim të bëhet diçka për këtë ndërsa kërkesa tjetër ka të beje me ndricimin rrugor në të njejtin fshat një lagje ka kohe që nuk ka të njejtën gjë dhe po ju lus të shkoni dhe ta rregulloni sa me shpejt. Kemi edhe një kërkesë tjetër për të cilën është vënë në dijeni kryetari i Komunës, bëhet fjalë për stadiumin në f.sh. Çellopek i cili ende nuk ka përfunduar, kërkohet që të kryhen punimet para apo pas zgjedhjeve.

Kryetari i Këshillit pyeti nëse kadikush tjetër për ndryshime apo plotësim në rendin e ditës.

Duke qenë se askush nuk nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit e hodhi në votim rendin e ditës dhe u miratua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

I

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së tridhjetë e tretë të Këshillit të Komunës së Bërvenicës, kryetari i Këshillit e lexoi të njëjtën gjë dhe pyeti nëse ka vërejtje për procesverbal.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim .

Duke qenë se askush nuk u paraqit për fjalë , Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën "Miratimi i procesverbalit të seancës së tridhjetë e tretë të Këshillit të Komunës së Bërvenicës" dhe u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

II

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për përcaktimin e lokacionit të përkohshëm për depozitimin e mbetjeve inerte (rrënojat e ndërtimit).,,

Kryetari i Këshillit ia dha fjalën atij përgjegjësit nga komuna.

Personi përkatës nga komuna e mori fjalën dhe tha se JPDP ka paraqitur kërkesë në komunë në lidhje me përcaktimin e lokacionit të përkohshëm për deponimin e mbeturinave ndërtimore që do të prodhohen si rezultat i procesit të ndërtimit të Korridorit 8 Seksioni Tetovë- Gostivari. Është truall me numer CP 2061 K.K Volkovijë. Është një gropë me përmasa 100 metra me 100, me thellësi 7 metra, e cila gjendet në mes të komunës së Vrapçishtit dhe Bërvenicës. Ky lokacion është kërkuar nga kompania publike dhe kontraktori BENTEL ENKA që të përdoret si vend për depozitimin e mbetjeve inerte. Kjo gropë mbulon edhe parcelat e tjera jo vetëm këtë 2061, ka edhe parcela private, do të miratojmë dhe do të japim mendim vetëm për këtë parcelë 2061 që është në R.M. dhe me parcelat private të merren vesh mes tyre se çfarë dhe si do të bëjnë.

Si komunë i kemi vendosur këto kushte: Ndërtimi i rrugës hyrëse nga nyja Negotinë-Pollog, rruga ekziston por duhet tampon dhe rregullohet. Një kusht i dytë u kërkuar nga ana jonë vetëm që rruga e ndërtimit të kryhet vetëm në atë rrugë dhe të mos kalojë nëpër fshatra të tjerë. Si pikë

e tretë, pas përfundimit të transportit dhe magazinimit të mbeturinave të ndërtimit, kjo parcelë të pastrohet, të mbulohet me dhe dhe të mbillet me bar nga ana jonë, ne kërkuam që tamponin që do ta heqin nga autostrada të na jepet, ta ruajmë në një vend që ta përdorim për tamponimin e rrugëve lokale. Na u pranuan të gjitha kushtet, tani ju si këshill, nëse pranoni ta lëshoni atë parcelë si vendgrumbullim të përkohshëm, ne në vetë vendimin do të shënojmë disa detyrime që të mbulohemi ligjërisht dhe gjithçka të jetë e rregullt.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim .

Abeb Nuhii u parqit për fjalë dhe tha, a ka mundësi të zgjerohet kjo kërkesë, sepse kemi shumë deponi ilegale në f.sh Miletinë dhe Çellopek, a ka mundësi që edhe ato të pastrohen. A ka ndonjë mekanizëm që të njëjtat të kontrollohen nga komuna që të mos hedhin mbeturina.

Përsëri e mori fjalën personi përgjegjës nga komuna dhe tha se na dhanë një mundësi në procesin e bashkëpunimit, për më tepër se ka mundësi që të arrijmë marrëveshje. Sugjerimet tuaja do t'i ndjekim aty për aty dhe do t'i përcjellim, besoj se do të pranohen prej tyre.

Duke qenë se askush nuku parqit për fjalë , Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën “Vendimi për përcaktimin e lokacionit të përkohshëm për depozitimin e mbetjeve inerte (rrënojat e ndërtimit)” dhe u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

III

Në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës, “Propozim-Vendim për zonat dhe lëvizjen e vlerës së tregut të tokës ndërtimore dhe bujqësore në rajonin e Bërvenicës, për rregullimin e tatimit në pronë dhe tatimin e qarkullimit të patundshmërive, trashëgimisë dhe dhuratës. ., .

Kryetari i Këshillit ia dha fjalën anëtarit përgjegjës të komunës.

Përgjegjësi nga Komuna tha se deri më tani kemi punuar me një vendim të vjetër nga viti 2014, unë si vlerësues mendoj se duhet një vendim i ri për shkak të rritjes së çmimit të tokës. Për tokën ndërtimore, taksa e qarkullimit dhe e trashëgimisë duhet të rritet për 200 denarë në të gjitha zonat, përveç në zonën 3-1 në fshatin Gurgurnicë. Për tokën bujqësore sipas klasave kadastrale dhe sipas grupeve, mendoj se çmimet duhet të rriten për 20 denarë për metër katror. Besoj se edhe për këtë duhet të merret një vendim me çmime të reja dhe të rritura.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim.

Kryetari i Këshillit tha se mendon se rritja duhet të jetë lineare për 100 denarë në të gjitha zonat.

Përgjegjësi nga komuna tha, në këto fshatra ku çmimet po rriten, mendoj se këto kohët e fundit janë më të lëvizshme, bëhet fjalë për shit-blerje dhe jo për ndërtim. Normat nuk kanë ndryshuar, ka ndryshuar vetëm baza tatimore.

Abeb Nuhiu u paraqit për fjalë dhe tregoi se si paguhej taksa me 2, 3, 4 përqind. Me këtë amendament duhet të jetë më e qartë për ne dhe për njerëzit. Pajtohem me Kryetarin që të jetë linear 100 denarë dhe të mos dëmtohet komuna. Ky çmim mund të jetë i ulët për Bërvenicën dhe Çellopekun, por jo i ulët për fshatrat e tjera. Nëse pajtoheni që rritja të jetë 100 denarë, do të thotë lineare, por ky është mendimi im.

Kryetari i Këshillit foli dhe tha se do të bëjmë maksimumin për të mbrojtur njerëzit dhe mendoj se rritja prej 100 denarë është reale.

Meqenëse askush nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit pikën, Vendimin për zonat dhe lëvizjen e vlerës së tregut të tokës ndërtimore dhe bujqësore në zonën e Bërvenicës, për rregullimin e tatimit në pronë dhe taksës së qarkullimit të patundshmërive, trashëgimia dhe dhurata „, e hodhi në votim dhe u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

IV

Në lidhje me pikën e katërt të rendit të ditës, Raporti përfundimtar i revizionit të brendshëm të punës së Sektorit për Administrimin e Tatimeve dhe Taksave në k. Bërvenicës për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Kryetari i Këshillit ia dha fjalën anëtarit përgjegjës të komunës.

Personi përgjegjës për revizion nga komuna lexoi raportin e revizionit .

Përgjegjësi për tatimet u paraqit për fjalë dhe tha, ne nuk i regjistrojmë personat juridikë, çdo vit parashtrojmë kërkesë deri në fund të vitit aktual që të na japin një CD me persona juridikë nga regjistri qendror. Sa do të na dorëzojnë prej andej, ne regjistrojmë aq persona juridikë, ka shumë dyqane që punojnë me ta dhe nuk paguajnë taksën e firmës, unë si udhëheqës i tatimeve nuk mund të bëj asgjë këtu. Nuk mund të regjistroj të gjitha dyqanet që shoh, nuk është përgjegjësia jonë. Ajo kompetencë është në nivelin e regjistrit qendror, jo në nivelin tonë.

Kryetari i Këshillit hapi debat .

Abeb Nuhiu u paraqit për fjalë dhe tha, ju keni regjistrin qendror ku mund të shihni kush paguan fimarina apo jo, mendoj se shumica e njerëzve janë të regjistruar, thjesht kanë nevojë për të dhëna. Nuk e di nëse duhet të regjistrohen këtu në komunë njëzëri që kanë firmë....duhet parë dhe ndjekur se kush nga keta 207 janë të regjistruar dhe paguar. Duhet të punohet me popullin që ta dinë që taksa i bën mirë atij dhe komunës , me ato para na ndërtohen rrugët, kanalizimet, infrastruktura.

Meqenëse askush tjetër nuk paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit e vendosi pikën Raporti përfundimtar i revizionit të brendshëm në funksionimin e Sektorit të Administrimit të Tatimeve dhe Taksave të k. Bërvenicës për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023. ..në votim dhe u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

V

Në lidhje me pikën e pestë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për shpërblim me para për kampionët e gjeneratës për vitin 2024.

Kryetari i Këshillit tha, për këto tri pikat e fundit nuk kemi asnjë material, do t'i kalojmë vetëm si raport, ashtu si vitin e kaluar, në seancën e ardhshme do të kemi vlerën e saktë për të gjitha këto pika.

Kryetari i Këshillit hapi debat .

Donço Simjanovski u paraqit për fjalë dhe tha se për këtë pikë kemi një vendim për vitin 2023. Për mendimin tim nxënësve duhet t'u jepet një shpërblim, por jo vlerë me para , por në vlerën e shumës që do të vendoset t'u jepet, për mendimin tim do të ishte më mirë t'u blihej një libër, po në atë libër të nënshkruar nga kryetari dhe drejtori i shkollës. Kështu që nxënësit do të kenë një kujtim për këtë vendim që do të marrim. Paratë si para do të shpenzohen, fëmijët nuk do të kenë kujtime dhe me kalimin e brezave kështu do të shihet se diçka do të mbetet për ta.

Abeb Nuhii u paraqit për fjalë dhe tha, desha të them më shumë për këto tri pika, fillimisht duhet të marrim një vendim që t'i shpërblejmë ata nxënës dhe pastaj drejtorët ose kryetari të vendosin se çfarë do të jetë. Ne nuk mund të vendosim asgjë për të. Këto tre pika kanë një karakter, drejtorët duhet të merren me këto punë për të parë sa fëmijë janë të semimaturuar, të bëjnë listat dhe t'i sjellin para kohe në komunë që të zbatohet më pas. Ne marrim një vendim këtu, por nuk kemi shumën që do të kushtojë, për të vendosur rendin dhe për të ditur se ku dhe si shpenzohen paratë.

Përsëri foli Donço Simjanoski dhe tha se drejtorët i zbatojnë vendimet tona. Vitin e kaluar kur e bëmë, drejtorët e kuptuan dhe nuk e zbatuan atë vendim tonën. Ke plotësisht të drejtë dhe jam dakort me ty që duhet të dime saktësisht sa fëmijë janë semimaturante dhe të klasës së parë, ndaj mendimi im ishte që në vend të shumës që duhet t'u japim, t'u japim diçka për të mbajtur mend.

Kryetari i Këshillit tha mes njëres dhe tjetres le të vendosin njerëzit në komunë se çfarë do të jetë, para në dorë apo libër, varësisht nga mundësitë e asaj që kemi ne si komunë. Gjithçka që thatë është e drejtë dhe është mirë, por deri në seancën e ardhshme do të kemi një arsyetim për të

ditur kornizën e parave të shpenzuara, sigurisht që nuk dyshojmë në punën e komunës, por si këshillë duhet të dimë se çfarë kemi votuar për.

Abeb Nuhiu u paraqit përsëri për fjalë dhe tha, ne japim dritën jeshile, por nuk e dimë se sa është. Ne kemi nevojë për një numër të saktë të fëmijëve, mendoj se kërkesa jonë është në vend dhe drejtorët duhet ta bëjnë në kohë për të dhënë numrin e fëmijëve.

Kryetari i Këshillit tha, propozoj të pranohet ky vendim dhe brenda mundësive të komunës të dërgojnë në e-mailin tonë gjithçka që është vendosur, por nuk do ta kalojnë kornizën nga viti i kaluar. Dua të them në pikën e vendosjes së parave ose një libri.

Duke qenë se askush tjetër nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën “Vendimi për shpërblimin me para për të parët e gjeneratës për vitin 2024” dhe u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

VI

Sipas pikës së gjashtë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për sigurimin e kapele, shalle dhe fotosesion për të gjithë semimaturantët t nga SHF në rajonin e Bërvenicës.

Kryetari i Këshillit tha se kjo pikë është diskutuar dhe shpjeguar në pikën e mëparshme.

Meqenëse askush nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën Vendim për sigurimin e kapele, shalle dhe fotosesion për të gjithë semimaturantët nga SHF në zonën e Bërvenicës.. dhe u pranuar njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

VII

Sipas pikës së shtatë të rendit të ditës, Propozim-Vendim për ndihmë financiare të njëhershme për blerjen e mjeteve shkollore për familjet me nxënës të klasës së parë në SHF në rajonin e Bërvenicës.

Kryetari i Këshillit tha, dhe kjo pikë u diskutua dhe u shpjegua njësoj si në dy pikat e mëparshme.

Meqenëse askush nuk u paraqit për fjalë, Kryetari i Këshillit hodhi në votim pikën “Vendimi për ndihmë financiare të njëherëshme për blerjen e mjeteve shkollore për familjet me nxënës të klasës së parë në SHKF në rajonin e Bërvenicës” dhe e njëjta u pranua njëzëri nga këshilltarët e pranishëm.

Pas shqyrtimit të pikave të rendit të ditës, përfundoi seanca e tridhjetë e katër e Këshillit të Komunës së Bërvenicës.

**Procesverbalist,
Natasha Stojçeska
Përktheu,
Ferdane Idrizi**

**Nr.08-559/2
29.04.2024 viti.
Bërvenicë**

Kryetar I Këshillit

Bujamin Rushiti